

Terma Reference

Thirrje për ekspert/lehtësues për ofrimin e ëorkshop-eve mbi zhvillimin e aftësive të prindërimit në Bashkinë Korçë

Konsulencë	Thirrje për ekspert/ lehtësues për ofrimin e ëorkshop-eve mbi zhvillimin e aftësive prindëruese të familjeve në nevojë në Bashkinë Korçë
Kohezgjatja e shërbimit	Qershor 2025-Mars 2026
Zona e projektit	Bashkia Korçë
Data e mundshme e fillimit të punës	6 Qershor 2025

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontraktojë një ekspert/lehtësues, për të ofruar një cikël workshopesh mbi zhvillimin e aftësive prindëruese të familjeve me nivel të lartë vulnerabiliteti, në Bashkinë Korçë, në kuadër të programit Bashkimi Evropian për Kujdesin Social (EU4SocialCare) i financuar nga BE dhe i zbatuar nga UNICEF Albania dhe World Vision Albania.

Kjo ekspertizë do të ofrohet në mbështetje të Bashkisë Korçë, Drejtorisë së Kujdesit Social, Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen dhe Nisma ARSIS për të fuqizuar komunitetin e prindërve dhe zhvilluar aftësi për një prindërim më cilësor, më mirëkuptues përkundrejt sfidave të zhvillimit të fëmijëve, përkujdesës dhe miqësor.

Rreth Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht NISMA ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Mision i NISMA ARSIS është angazhimi për avancimin e të drejtave të fëmijëve, të rinjve dhe familjarëve të tyre që përballen me vulnerabilitet, duke ofruar shërbime gjithëpërfshirëse dhe duke lehtësuar integrimin me dinjtet të tyre në shoqëri. NISMA ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Përshkrimi i Projektit

Projekti po zbatohet në Bashkinë Korçë “Forcimi i krijimit dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit social për të mbrojtur fëmijët dhe komunitetet vulnerabël në Bashkinë e Korçës dhe Durrësit” në kuadër të programit Bashkimi Evropian për Kujdesin Social (EU4SocialCare) i financuar nga BE dhe i zbatuar nga UNICEF Albania dhe World Vision Albania. Metodologjia e propozuar bazohet në parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (CRC), standardeve ndërkombëtare të kujdesit alternativ për fëmijët dhe prioritetet kombëtare, duke përfshirë programin e Qeverisë së Shqipërisë, i cili synon të avancojë një sistem të mbrojtjes sociale gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm për të mbështetur individët gjatë gjithë ciklit të jetës. Ajo përdor një model socio-ekologjik që vendos fëmijën në qendër të të gjitha ndërhyrjeve, i rrethuar nga katër shtresa kryesore: kujdestarët/familja,

komuniteti, kultura dhe shoqëria, si dhe mjedisi më i gjerë/politikat.

Në bashkinë Korçë, Qasja përqendrohet në krijimin e një modeli të plotë dhe multidisiplinor të shërbimeve, i cili ka në prioritet integrimin e kujdesit dhe mbrojtjes sociale, me fokus në përfitimet për fëmijët, mbështetjen familjare dhe përmirësimin e cilësisë dhe aksesit të shërbimeve të kujdesit. Nevojat e menjëhershme dhe afatgjata të fëmijëve adresohen përmes planeve të mbështetjes individuale dhe menaxhimit të integruar të rasteve. Këto përfshijnë këshillimin, terapinë dhe ndihmën psikosociale për të forcuar qëndrueshmërinë emocionale, së bashku me mbështetje të personalizuar arsimore dhe aktivitete të përfshirjes në komunitet. Qëllimi është të sigurohet që çdo fëmijë të zhvillohet në një mjedis të kujdesshëm që ka në prioritet mirëqenien, zhvillimin dhe ndjeshmërinë e tij/saj ndaj çështjeve gjinore. Projekti fuqizon kujdestarët, duke përfshirë familjet biologjike, ofruesit e kujdestarisë alternative dhe stafin institucional, me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të ofruar kujdes cilësor. Një fokus i veçantë i kushtohet përfshirjes aktive të baballarëve dhe kujdestarëve meshkuj, duke i inkurajuar ata të marrin pjesë në mënyrë aktive në rolet prindërore dhe të kujdesit.

Nën mbështetjen dhe bashkëpunimin me ekipin koordinues të programit dhe të SHMFF, ***Ekspteri/ekspertja, do të ketë këto deyra dhe përgjegjësi:***

- Të ofrojë programin e prindërimit “Unë jam këtu për ty”.
- Të forcojë aftësitë prindërore përmes konceptit të prindërimit pozitiv me qëllim final të reduktimit të rrezikut të abuzimit dhe ndarjes së fëmijëve nga familja.
- Të promovojë teknika të disiplinimit pozitiv.
- Të nxisë komunikimin pozitiv dhe mirëkuptimin në familje.
- Të ndihmojë familjet në përballimin e sfidave të jetës së përditshme, ngjarjeve të pazakonta apo të papritura.
- Të reduktojë impaktin që mund të kenë situatat e vështira në shëndetin e fëmijës dhe familjes.
- Të zhvillojë njohuritë e prindërve mbi mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve.
- Të zhvillojë periodikisht klasat e prindërimit në përputhje me sesionet e modulit dhe sipas njësive administrative.

Zhvillimi i përmbajtjes së workshop-eve:

- Përgatitja e moduleve interaktive në përputhje me udhëzimet e organizatës dhe protokollin e ofrimit të modulit “jam këtu për ty”
- Lehtësimi i workshop-eve
- Planifikimi dhe lehtësimi i workshop-eve me grupe prindëresh në mënyrë dinamike dhe pjesëmarrëse
- Përshtatja e qasjeve sipas nevojave të pjesëmarrësve dhe kontekstit lokal.
- Monitorimi dhe mbledhja e feedback-ut
- Përdorimi i mjeteve për vlerësim para/pas workshop-it për të matur përmirësimin e njohurive ose ndryshimet në qëndrim
- Reflektimi mbi reagimet e prindërve për të përmirësuar seancat në vijim
- Bashkëpunimi me stafin e organizatës dhe koordinim i rregullt me stafin përgjegjës për programin.
- Raportimi periodik mbi progresin dhe çdo sfidë të evidentuar gjatë zbatimit.

Rezultatet e pritshme

- Zhvillimi i një pakete modulare trajnimit për prindërimin pozitiv (materiale për printim ose prezantim).

- Lehtësimi i 96 seancave me grupe prindërishe (100 prindër). *(parashikohet 2/3 seanca në javë dhe lokacioni pranë Njësive administrative të Bashkisë Korçë)*
- Raport përmbledhës në fund të angazhimit me vlerësime dhe rekomandime.

Përmes trajtimit të një sërë çështjesh të rëndësishme, synohet të fuqizohet prindi në përvetësimin e strategjive dhe aftësive me qëllim ndërtimin dhe ruajtjen e një marrëdhënieje të shëndetshme me fëmijën, si një ndër faktorët mbrojtës më të rëndësishëm kur diskutohet mbi ndarjen e fëmijës nga familja.

Kualifikimet:

- Diplomë universitare në Shkencat Sociale (psikologji, punë sociale, edukim, shkenca sociale ose fusha të ngjashme)
- Kualifikime që lidhen me çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe familjeve;

Eksperienca:

- Të ketë experience pune mbi 3-5 vjet përvojë pune me prindër ose familje në kontekst komunitar ose institucional, pjesë e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, shërbimet shoqërore dhe punës për fuqizimin e familjeve dhe komunitetit;
- Përvoja të mëparshme në organizata partnere të shoqërisë civile (preferohet);
- Përvojë e mëparshme në lehtësimin e trajnimeve, grupeve mbështetëse ose ëorkshop-eve.
- Preferohet njohje me konceptin e prindërimit pozitiv dhe qasjeve të bazuara në të drejtat e fëmijës
- Të jetë njohës i mirë i paketës ligjore për politikën e mbrojtjes së fëmijëve;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe ndërveprimi me grupe të ndryshme si dhe të menaxhimit të situatave
- Aftësi shumë të mira të përdorimit të kompjuterit, paketa Microsoft Word, Excel, email, etj
- I/e gatshëm/e për të udhëtuar/lëvizur në terren
- Aftësi për të përshtatur materialet sipas grupit të synuar dhe kontekstit lokal.
- Të kuptojë dhe të dakortësojë me misionin dhe qëllimin e Nisma ARSIS
- Aftësi shumë të mira në arritjen e afateve;
- Aftësi për të punuar në presion kohe, në punë në grup dhe në mënyrë të pavarur

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikën e mbrojtjes së fëmijëve, politikën e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

Koha e mundshme e fillimit të punës është 6 Qershor 2025.

Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit është përgjatë periudhës qershor 2025- mars 2026 .

Kjo ekspertizë përfshin 96 ditë pune.

Procedura e aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për këtë thirrje duhet të dërgojnë me email :

1. CV-në;
2. Letër interesi;
3. Letër angazhimi/disponueshmërie;
4. Ofertën financiare.

brenda dates **2 qershor 2025** në info@nisma-arsis.org , ose me postë në adresën: Rruga "Sali Butka", Pallati T.B.M, Shkalla 2, Apartamenti 1, Kati 1, Njësia Bashkiake Nr.7, PC 1023, Tirana Albania.

Procedura e Vlerësimit:

Zgjedhja e ekspertit do të bazohet në:

- se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës,
- eksperiencat e relevante të mëparshme
- oferta financiare
- gjithashtu edhe bazuar në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

Kriteret e vlerësimit	Vlerat në %
Kualifikime	30%
Eksperiencë pune	50%
Oferta financiare	20%

Ju lutemi, në vemendjen tuaj që:

- në subjekt të emailit ose zarfit ku dërgohet aplikimi të vendoset: **Aplikim për thirrjen për ofrimin e workshop-eve mbi zhvillimin e aftësive të prindërimit në Bashkinë Korçë**
- vetëm personat e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.